



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 06-350-9402/16
Kaçanik, 30.03.2016

Në bazë të nenit 4 pika 3.3.14 dhe 3.3.15 të Ligjit Nr. 03/L-139-Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme i datës 26 mars 2009 si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 –Për Ndryshim Plotësimin Ligjit Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, të nenit 12, 14 dh 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), të nenit 6.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK, Z. K NË KAÇANIK TË VJETËR, PËR “ NDËRTIMIN E IMPIANIT PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA”

1. Me këtë Vendim shpallen me interes të përgjithshëm, pronat private në Zonat Kadastrale në Kaçanik të Vjetër, për projektin“ Ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza” në Kaçanik të Vjetër.
2. Patundshmëria në të cilën duhet të ndërtohet Impianti i trajtimit të ujërave të zeza përbëhet nga parcela kadastrale me numrat si vijon: 00068-2; 00068-3; 00068-4; 00068-5; 00069; 0,00070-0; 00071-0; 00072-0; 00073-0; 00074-0; 00075-0; 00076-0; 00077-0; 00078-0; 00079-1; 00079-2; 00079-3; 00079-4; 00080-0; 00081-0; 00210-0; 00211-0; 00212-0; 00213-0; 00214-0; 00215-0; 00216-0 dhe 00217-0; prona private në Z.K Kaçanik i Vjetër.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë ; certifikatat për parcelat kadastrale si në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Ndërtimi i Impiantit të përcaktuar si në pikën 1.të këtij Vendimi, është në interes të përgjithshëm publik dhe se lidhur me të mund të filloi procedura e shpronësimit, ne parcelat kadastrale me numrat e përcaktuar si në pikën 2. të këtij Vendimi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do te kujdesët, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, ashtu që obligohet kjo drejtori t'i merr të gjitha veprimet e nevojshme të shpronësimit të pronave të përcaktuara, në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë çështjen e shpronësimit të pronave të paluajtshme.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

